33.4 Pas pranimi të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i

projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të

arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 617-24-10126-5-2-1/C787

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës për periudhën deri më 11.12.2025 pastaj do të nënshkruhet kontrata .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	1. Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve 2. humbje ose dëmtim i Pajisjeve 3. humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) 4. dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit (ii) të personave të tjerë Përgjegjësi mbanë kontraktuesi (OE)
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim programin për punët brenda <i>tri</i> ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: 18.11.2024
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha punëve do të jetë 18.11.2025
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	OE është i obliguar të mbajë regjister të punës, dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm. OE është i obliguar që ta vendosë (Panon) me dimensione 2x1.5 m në vend ndërtim

		me informata si në vijim : a) Emri i Projektit b) Invesititorët(Ministria edhe Komuna) me llogot e tyre c) Emri i OE dhe kohëzgjatja e punimeve
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i projektit emrohet nga ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mënyra e Pagesave	30.1	Pagesat do të bëhen në bazë të Marrëveshjes së mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit , e nënshkruar me datë 26.07.2024 nr.2191 protokoli i ministrisë, dhe nr. 02/123 protokoli i Komunës në mes Ministres znj, Arbërie Nagavci dhe Kryetarit të Komunës Qemajl Aliu, neni 2 dhe neni 3 e marrëveshjes, pagesat për këtë projekt bëhen në bazë të realizimit të punimeve sipas kushteve të kontratës , gjithsesi deri në shpenzimin e mjeteve të zotuar të buxhetit të MASHTI-të. MASHTI-ti nga buxheti i vitit 2024 financon këtë projekt në vlerë prej 50,000.00 euro, dhe për 2025 prej 79,845.14 € Pagesat do të bëhen në bazë të situatave (Çertifikatave) të verifikuara nga Menaxheri i kontratës. OE duhet të sjellë këto dokumente për pagesën e fundit : 1.Garancioni për punët e kryera për(12 muaj) 2.Raporti i pranimit teknik nga komisioni. 3.Situacioni përfundimtar . 4.Fatura e rregullt. 5.Raporti nga mbikqyrësi për përfundimin e punëve me plan dinamik
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	OE, është i obliguar të sjellë një garancion bankar ose nga kompania e sigurimit të vlerës së 10% të kontratës për periudhën 12 mujore nga data e pranimit teknik të projektit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve .AK do të bëjë pagesën e punëve të përfunduara , të vërtetuara nga menaxheri i kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Palet kontraktuese do të bëjnë përpjekje për ti zgjidhur mosëmarrëveshjet eventuale , përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore</i>

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet lënda në gjykatën Kompetente .
--	------	--

NDËRTIMI I ÇERDHESE NË QYTETIN E SHTIMES

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Shënim: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit, në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhueseve si dhe përgatitjen e vizatimeve detale për ekzekutimin e pozicioneve të caktuara me kërkesë të organit mbikqyres ('Shop Drawings') dhe metodën e ekzekutimit të pozicionit përkatës, sipas përshkrimit teknik dhe specifikimit të materialeve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tere materiali shpenzues deri në leshuarjen në funksion. Përzgjedhja e tekstures, ngjyrës dhe elementeve tjera vizuale në materialet për ekzekutimin e punimeve finale duhet të bëhet nga investitori/ organi mbikqyres. Llogaria e sasive të sakta të ekzekutuara për pagesë, do të bëhet me libër nderimor, pas përfundimit të interesit të pozicioneve.

Të dhënat teknike dimensionet, sasitë, etj. përmes kësaj kontrate duhet të jenë me SI – Sistem ndërkombëtar të njësive (International System of Units). Dimensionet për realizimin e pozicioneve gjithmone të merren dhe verifikohen në vend, para fillimit të realizimit të pozicionit. Të gjitha Produktet e propozuara duhet të përcillen me Certificate kualiteti të prodhuesit duke i përmbushë ISO standardet.

Në këtë paramasë paraqitet krahasimi i sasive sipas paramasës bazë të projektit dhe sasive të kontrolluara nga Alb-Architect me kërkesë të menaxhereve nga Masht. Kontrolla është bërë bazuar në projektin që është marrë nga MASHT. Disa pozicione janë plotësuar me përshkrim me detaj për të paraqitur me detajsh materialet dhe aktivitetet që përfshihen në atë pozicion. Pavarësisht kësaj kontrole sasitë e sakta verifikohen pas ekzekutimit me libër nderimor që përgatitet nga punëkryesi dhe kontrollohet nga organi mbikqyres.

A	PUNËT NDËRTIMORE DHE ARKITEKTURA				
A.1	PUNËT PËRGATITORE	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
1.1	Inçizimi gjeodezik dhe shenjëzimi i lokacionit ekzistues sipas specifikimeve teknike, si dhe përcjellja e punimeve në vazhdimësi me instrumente gjeodezike deri sa të përfundojnë punimet në objekt.	m ²	1,246	1.00	1,246.00 €
1.2	Organizimi i punishtes, nënkupton të gjitha aktivitetet dhe veprimet të cilat duhet t'i ndërmarrë punëkryesi që punët e kontraktuara të realizohen në pajtim me Ligjet, rregullat në fuqi dhe kushtet teknike (Ligji i Ndërtimit, Kodi Unik i Republikës së Kosovës dhe Standardet e Ndërtimit të Kosovës) si sigurimi i punishtës, rrethimi, shenjëzimi i dukshëm me shenja treguese për rreziqet që mund t'u kanosen kalimtarëve, vendosjen e tabelës informuese, ndërmerr masa për sigurimin e ndërtimit dhe ndërtimeve fqinje, s, njëherit nënkupton edhe sigurimin e hapësirave adekuate përcjellëse si dhe largimin e tyre pas përfundimit të ndërtimit. Sjellja e materialit dhe rrethimi i punishtes, me gardh jo transparent me lartësi dhe të dhëna sipas specifikimit dhe përshkrimit teknik. Gjatesia e rrethojës është 150.0m' Dizajnimi dhe konstruktimi i tabelës informuese me dimensione 1.5m x1.0m dhe emër të projektit, investitorit, kompanisë projektuese dhe kontraktorit. Tabela të konstruktohet sipas detalit. Sigurimi dhe vendosja e kontenierëve në punishte gjatë gjithë kohës për nevojat e punëkryesit, puntoreve, organit mbikqyres, për materialet, tepricat, dhe mbeturinat të cilat duhet të largohen dhe të dërrqohen në deponinë e autorizuar (sipas përshkrimit	komplet	1	900.00	900.00 €
1.3	Qasja në Shërbimet komunale (ujesjellës, kanalizim, mbeturina), në shërbimet e KEDS-it	komplet	1.00	1500.00	1,500.00 €
1.4	Testimi i materialeve, pajisjeve, strukturat dhe sigurimi i cilesise sipas specifikimit teknik.	komplet	1.00	500.00	500.00 €

1.5	Pastrimi i terrenit-lokacionit nga të gjitha objektet ekzistuese, mbeturinat dhe gjësendet e dëmtuara nëpër sipërfaqet të cilat parashihen të ndërtohen (pilatave dhe shtigjeve ekzistuese). Si dhe largimi i të gjitha pengesave nën sipërfaqen e tokës që mund të shfaqen si: instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimet e ngrohjes, instalimet e telefonisë etj. Dislokimi i tyre në një pozicion tjetër ku nuk e pengon fundimin e objektit që ndërtohet.	komplet	1.00	6000.00	6,000.00 €
1.6	Punimi i skicave të punishtes, manualeve të përdorimit dhe Punimi i dokumentacionit Teknik-sipas realizimit ("As Build")	komplet	1.00	1000.00	1,000.00 €
1.7	Mbrojtja e zdrukthtarisë së brendshme dhe të jashtme në objekt, pra dritareve dhe dyerve, inventarit dhe elementeve të tjera në ato vende ku nuk janë paraparë riparime dhe sanime për të parandaluar dëmtimet fizike gjatë ekzekutimit të punimeve. Sigurimi të bëhet me dy shtresa: foli dhe PVC.	komplet	1	500.00	500.00 €
Pozicioni total A.1:					11,646.00 €
A.2	PUNËT E DEMOLIMIT	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
2.1	Te punët demoluese përfshihen (1) largimi, gërrimi dhe pastrimi i dyshemeve dhe mureve ekzistuese nga laminati dhe pllakat me qëllim të zëvendësimit me laminat dhe pllaka të reja (2) largimi i derës së jashtme ekzistuese (3) largimi i dyerve të brendshme ekzistuese (4) largimi i sanitarisë (lavamanëve, wc-ve, urinarëve) me qëllim të zëvendësimit të tyre (5) gërryerja dhe pastrimi i mureve dhe tavaneve me qëllim të nivelizimit dhe ngjyrosjes (6) gërryerja dhe pastrimi i fasadës së jashtme me qëllim të nivelizimit dhe ngjyrosjes. Në çmim të përfshihen të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e këtij pozicioni. Materiali i tepërt ngarkohet dhe transportohet deri në deponin më të afërt të përcaktuar nga organi mbikëqyrës. Para vendosjes së çmimit për këto punime është e domosdoshme që OE të bëjë vizite në terren dhe të njohet me gjendjen e secilit pozicion, në të kundërt mbetet nën përgjegjësi të tij të mbulojë çdo punim tjetër shtesë për demolimin e interesit.	komplet	1	2,500.00	2,500.00 €
2.2	Fiksimi dhe kalibrimi i të gjitha dritareve ekzistuese	komplet	1	2,000.00	2,000.00 €
2.3	Zëvendësimi i xhamave të dëmtuar në dritaret e jashtme. Xhami duhet të jetë dy-shtresor, i kristalizuar ose zalluar, me trashësi sipas gjendjes ekzistuese por jo më shumë se 5mm	m2	16	45.00	720.00 €
Pozicioni total A.2:					5,220.00 €
A.3	PUNËT E NGJYROSJES DHE MOLERIMIT	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
3.1	Përgatitja e sipërfaqeve duke përfshirë edhe larjen e hapsirave nën presion për të eliminuar çdo papastërti, rregullimi i plasaritjeve të dëmtuara të murit dhe tavaneve me llaq vazhdues MP75, si dhe përgatitja e sipërfaqeve për ngjyrë.	komplet	1.00	1300.00	1,300.00 €
3.2	Furnizimi me material dhe gjetimi i mureve dhe tavaneve duke përfshirë shtresat e nevojshme dhe gërryerjen deri në përgatitjen finale të për ngjyrosje.	m2	1150.00	4.50	5,175.00 €

3.3	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe ngjyrosja e mureve të brendshme dhe Pllafoneve, me ngjyrë akrilike me veti te pastrimit. Ngjyrë me cilësi të lartë, rezistente ndaj larjes dhe lehtë e pastrueshme. Lloji i ngjyrës përcaktohet nga Inxhnieri Mbiqkyrës, sipas Manualeve të Prodhuësit. Në llogari duhet të përfshihet përgatitja e sipërfaqes me bazë emulsioni, për të arritur sipërfaqe të përshtatshme për ngjyrosje. Llogaritja duhet të bëhet për m ² , pa i llogaritur hapjet.	m2	1150.00	5.00	5,750.00 €
Pozicioni total A.3:					12,225.00 €
A.4	PUNËT E DYSHEMESË	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
4.1	Pastrimi i dyshemesë dhe përgatitja e dyshemesë me laminat, të cilat duhet të zëvendësohen me laminat të ri. Dyshemeja pastrohet nga mbeturinat e llaqit, gëlqeres dhe përbërësve tjerë. Nëse është e nevojshme për heqjen dhe pastrimin e mbeturinave të përforcuar përdoret zbutës i përshtatshëm apo aplikohet larja me ujë nën presion.	m2	190.00	3.50	665.00 €
4.2	Furnizimi, transporti, punimi si dhe montimi i dyshemesë nga laminati më dizajn "Natur" ose e përshtatshme, me veti të larta kundër reshqitjes dhe gërryerjes-32, trashësi t=14 mm. Në çmim përfshihet edhe montimi i folies prej najloni PVC 2 mm, montimi i dyshemes si dhe montimi i shiritave adekuatë të skajit në perimetër e kthines, lajsnet këndore.	m2	190.00	15.00	2,850.00 €
Pozicioni total A.4:					3,515.00 €
A.5	PUNËT E KERAMIKËS DHE PLLAKAVE	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
5.1	Pastrimi i dyshemesë dhe përgatitja e dyshemesë me pllaka, të cilat duhet të zëvendësohen me pllaka keramike të reja. Dyshemeja pastrohet nga mbeturinat e llaqit, gëlqeres dhe përbërësve tjerë. Nëse është e nevojshme për heqjen dhe pastrimin e mbeturinave të përforcuar përdoret zbutës i përshtatshëm apo aplikohet larja me ujë. Në çmim përfshihen pastrimi, gërryerja, nivelizimi me shtresë rrafshuese si dhe përgatitja e gjithëmbarrësme për vendosjen e pllakave.	m ²	113.50	4.00	454.00 €
5.2	Furnizimi i materialit si dhe punimi i pllakave keramike në dyshemetë e koridoreve dhe kuzhines. Pllakat të jenë të klasit të parë të pajëmuara, me fortësi mekanike prej 50N/mm ² me dimensione 60x60x0.8 cm. Mbrojtja nga ngricat dhe acaret, apsorrimi i gërryerjes duhet të jetë nën 0.5%. Tharrirat kimike dhe rezistenca baze sipas NI EN ISO 10545-13. Pllaket duhet të vendosen sipas EN 13888 standardeve. Në çmim të llogaritet edhe vendosja e cokolles me lartësi t=10.0cm. Ngjyra dhe modeli i pllakave caktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	90.00	10.00	900.00 €

5.3	Furnizimi i materialit si dhe punimi i pllakave keramike në dyshemetë e nyjeve sanitare . Pllakat të jenë të klasit të parë të palëmuara, me fortesi mekanike prej 50N/mm2 me dimensione 30x30x0.8 cm. Mbrojtja nga ngricat dhe acaret, apsorbimi i gërryerjes duhet te jetë nën 0.5%. Thartirat kimike dhe rezistenca baze sipas NI EN ISO 10545-13. Pllaket duhet të vendosen sipas EN 13888 standardeve. Ne cmim te llogaritet edhe vendosja e cokles me lartesi t=10.0cm. Ngjyra dhe modeli i pllakave caktohet nga organi mbikqyrës.	m²	30.00	25.00	750.00 €
5.4	Furnizimi i materialit si dhe punimi i pllakave keramike në muret (deri në lartësi 2.10 m-niveli i deres) e nyjeve sanitare, të kuzhinës si dhe ne dyshemetë e koridoreve dhe ngrohjes. Pllakat të jenë të klasit të parë të palëmuara, me fortesi mekanike prej 50N/mm2 me dimensione 30x30x0.8 cm. Mbrojtja nga ngricat dhe acaret, apsorbimi i gërryerjes duhet te jetë nën 0.5%. Thartirat kimike dhe rezistenca baze sipas NI EN ISO 10545-13. Pllaket duhet të vendosen sipas EN 13888 standardeve. Çmimi parasheh edhe mveshjen e mureve të hapësirës së dedikuar të kuzhinës deri në lartësi h -140 cm paashtu edhe ngjitësi i pllakave si dhe te gjitha punimet deri ne finalizim. Ngjyra dhe modeli i pllakave caktohet nga organi mbikqyrës.	m²	175.00	5.00	875.00 €
5.5	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i pllakave me dimezone 33x33x 3.0 cm të granilit natyral te parahyrja dhe shkallët e jashtme në pjesë mbrapa objektit. Montimi te kryhet me ngjites special adekuat per pllaka graniti. Në çmim të parashihen të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e këtij pozicioni.	m²	4.00	50.00	200.00 €
Pozicioni total A.5:					3,179.00 €
A.6	PUNËT E FASADËS	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
6.1	Përgatitja e sipërfaqeve, rregullimi i plasaritjeve të dëmtuara të mureve të fasadës me llaq vazhdues si dhe përgatitja e sipërfaqeve për ngjyrë.	komplet	1.00	1500.00	1,500.00 €
6.2	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe instalimin permes lidhjes me ngjitës të përshtatshëm dhe ankorues EPS (Stiropor) në fasadë, me trashësi t=5cm, λ=0.035 W/mK, pesha >18kg/m3, në pjesën e jashtme të murit. Ne pune te perfshihet edhe trajtimi i urave termike sipas projektit kryesore. Në llogaritje të përfshihet edhe shtresa e ngjitësit, rjetë të përforcuar , shtresa tjetër e ngjitësit, baza per shtresen finale te fasades,shtresa finale dekorative e fasades me strukture 1,5mm me me baze Silikon, dhe dy shtresa ngjyre finale me baze Silikoni. Në çmim të përfshihet edhe përpunimi i bazes se fasades ekzistuese dhe trajtimi dhe mbushja e plasaritjeve ne fasaden paraprake me material adekuat, sipas Specifikimit Teknik.	m2	320.00	5.00	1,600.00 €

6.2	Blerja, furnizimi dhe ngjyrosja e murevet ballor të fasadës si dhe strehës së objektit me ngjyrë akrilike ekologjike për ambiente të jashtme, e cila përzihet me mikser në një enë të posaqme, pastaj bëhet molerimi (ngjyrosja) në dy shtresa deri sa të arrihet toni dhe nuanca e ngjyrës e cila korrespondon me ngjyrën ekzistuese të fasadës. Në çmim përfshihet: gërryerja, rrafshimi, nivelizimi i këndeve horizontale dhe vertikaleve, suvatimi me gledë dhe ngjyrosja me ngjyrë deri në tonin dhe nuancën e dëshiruar.	m2	280.00	15.00	4,200.00 €
Pozicioni total A.6:					7,300.00 €
A.7	PUNËT E DYERVE	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
7.1	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe Montimi i Dyerve me Profile Alumini (gjerësia e profilin min.75mm,dhe xham dy shtresore, xham 4 (i temperuar/ekuivalent))+16+4(Low-E), sipas Specifikimit Teknik,Projektit kryesor dhe Skemave të Dyerve. Në llogaritje të përfshihen të gjithë elementet shtrenguese, dorezat, përpunimi i mureve të demtuara gjatë procesit të nderimit perreth kornizes se dyerve etj. Dimensionet e deres 3.80x3.0m	cope	1.00	1500.00	1,500.00 €
7.2	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe Montimi i deres se Erembrojtesit me Profile Alumini (gjerësia e profilin min.75mm,dhe xham dy shtresore, xham 4 (i temperuar/ekuivalent))+16+4(Low-E), sipas Specifikimit Teknik,Projektit kryesor dhe Skemave të Dyerve. Në llogaritje të përfshihen të gjithë elementet shtrënguese, dorezat, përpunimi i mureve të demtuara gjatë procesit të nderimit perreth kornizes se dyerve etj. Dimensionet e deres 1.90x2.50m	cope	1.00	1500.00	1,500.00 €
7.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës së brendshme njëkrahëshe me mekanizë për hapje me rrëshqitje. Dera duhet të jetë nga druri me mekanizma metalik për rrëshqitje, me hapje 67 cm dhe lartësi 280 cm. Në kalkulim të përfshihen të gjitha materialet dhe elementet e nevojshme për montimin e derës si dhe mekanizmi i hapje-mbylljes sipas prodhuesit. Ofertuesi duhet të vizitojë çerdhën për të vlerësuar llojin më të përshtatshëm të derës për objektin. Të gjitha punët duhet të kryhen në pajtim me projektantin dhe në udhëzim të organit mbikëqyrës.	copë	1.00	500.00	500.00 €
7.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyerve të brendshme një krahëshe me 1 ndarje vertikale me dimensione totale 85x200cm në kthinat e çerdhës. Dyert janë me kornize celiku dhe flete nga Mediapani te lehtësuara dhe me mbushje me hoje, me ngjyre të përcaktuar nga investitori. Në kalkulim të përfshihen të gjitha materialet dhe elementet e nevojshme për montimin e dyerve. Shënim: Përpara se të blihen dyert duhet të bëhet një matje e dytë nga ana e ofertuesit me qëllim të përcaktimit të saktë të hapësirave të dyerve.	copë	7.00	200.00	1,400.00 €

7.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i dverve të brendshme një krahëshe me 1 ndarje vertikale me dimensione totale 80x300cm nëpër toailete. Dyerit janë nga PVC me ngjyrë të përcaktuar nga investitori. Në kalkulim të përfshihen të gjitha materialet dhe elementet e nevojshme për montimin e dverve. Shënim: Përpara se të blihen dyert duhet të bëhet një matje e dytë nga ana e ofertuesit me qëllim të përcaktimit të saktë të hapësirave të dverve.	copë	5.00	150.00	750.00 €
Pozicioni total A.7:					5,650.00 €
A.8	PUNËT E TJERA	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
8.1	Furnizimi me material dhe perforcimi i konstruksionit të kulmit nga druri me elementet sipas nevojës për të siguruar stabilitetin e tij konform rregullave teknike.	m3	5.00	400.00	2,000.00 €
8.2	Furnizimi me material dhe zevendesimi i tjegullave të demtuara të kulmit. Forma dhe dimensionet e tyre të jetë të ngjashme me ato ekzistuese.	m2	35.00	45.00	1,575.00 €
8.3	Furnizimi me material dhe vendosja e termoizolimit të kulmit me EPS trashësi t=15.0 cm dhe vendosja e shtresës së estrikut min 5.0cm duke përdorur penden kundër avullit dhe shtresën PVC folie në mes.	m2	370.00	4.00	1,480.00 €
8.4	Furnizimi me material dhe punimi i gomës në këndet e lojërave. Punimi i dyshemesë nga goma me shtresë të dyfishtë: sistemi me spërkatje (spraycoat). Struktura bazë të jetë e punuar nga granulat SBR -gomë e ricikluar 1-3,5 mm, e ngjitur me ngjitës adekuat dhe shtresa e epërme me stërpikje me poliuretan dhe granula EPDM :0,5 - 2,5 mm dhe EPDM puder 0.0 - 0,5mm-dy herë. Produkti të plotësojë standardet DIN V 18035-6, EN-14 977, IAAF ose të ngjajshme. Trashësia e tërës shtresave min. 13 -14 mm. Të gjitha shtresat e dyshemesë të jenë sistem i një prodhuesi duke përfshirë edhe ngjitësat adekuat. Ky pozicion të realizohet me domos nga stafi profesional i trajnuar për realizim të produktit dhe në tërësi sipas udhëzimeve të prodhuesit etj. duke përfshirë edhe pastrimin paraprak të bazës dhe pregaditjen e nënbazës. Të ofrohet garancia në prodhim/material (min. 5 vite) dhe në realizim (min. 3 vite). Obligim i punëkryesit është sigurimi i materialit dhe prodhimit gjatë realizimit dhe mbrojtja nga ndikimet atmosferike (të reshurat, dielli etj.). Kjo dyshemë punohet të fusha e sportit dhe shtegu për jogging. Punëkryesi gjatë ofertimit të prezantojë katalogun e materialit - prodhuesit dhe metodologjinë e realizimit. Llogaritja bëhet me çmim njësi.	m2	79.50	10.00	795.00 €
8.5	Furnizimi me material si dhe montimi i luhatësve për fëmijë të vegjël 3-12 vjet (Steel swings) me 2 luhatë, luhatet metalta dhe me drrasa të klases 1 të ngjyrosura të lidhura me zingjir në llogaritje të salduar në gyp metalik 90mm. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet.	copë	3.00	1500.00	4,500.00 €
8.6	Furnizimi me material si dhe montimi i lodrave për fëmijë të vegjël (3-8) vjet, lodrat katë shalë me suste për levizje (Springers) nga materiali polimer. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet.	copë	3.00	800.00	2,400.00 €

8.7	Furnizimi me material si dhe montimi i lodres tip rrëshqitëse Topogan për fëmijë 0-6 nga materiali Polister apo ngjashme me kull vrojtimi. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet.	copë	1.00	2500.00	2,500.00 €
8.8	Furnizimi me material si dhe montimi i lodres shah në dysheme për fëmijë të vegjël (0-6) vjet .Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet.	copë	2.00	2500.00	5,000.00 €
8.9	Furnizimi me material si dhe montimi i lodres cilindra te niveleve te ndryshme për fëmijë të vegjël (0-6) vjet .Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet.	copë	2.00	1500.00	3,000.00 €
8.10	Furnizimi, transporti, mbjellja me dhe organik, mbjellja dhe mirëmbajtja e gjelbërimit - barit italian deri në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e duhur për zhvillim me dendësi 30-40 gr/m ² ose sipas udhëzimit të prodhuesit si dhe furnizimi dhe mbulimi me një shtresë të imët dheu pas mbjelljes, rrafshimi me ngjeshje me cilindër të dorës/kopsharit prej 50-60 kg. Në çmim përfshihen të gjitha elementet dhe materialet e nevojshme për realizimin e këtij pozicioni.	m2	559.00	3.50	1,956.50 €
8.11	Pastrimi, larja, dizinfektimi i gjithëmbarshe i hapesirave te brendshme te objektit pas perfundimit te punimeve. Materiali i cili pastrohet te largohet nga objekti.	komplet	1.00	2500.00	2,500.00 €
8.12	Planifikimi dhe punimi dhe furnizimin e zallë rekreative në këndin e fëmijve në zonë e parapare për zallë deri 25m trashësi . Rrafshimi të bëhet me thellësi sipas kuotave të projektit.	m2	50.00	45.00	2,250.00 €
Pozicioni total A.8:					29,956.50 €
A.9	PUNËT E MOBILARIT TË BRENDSHËM	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Shuma €
9.1	Furnizimi dhe transporti i robalarësës me kapacitet 10 kg. Rrobalarësja duhet të jetë e cilësisë së lartë si dhe me garanci shumëvjeçare.	copë	1.00	500.00	500.00 €
9.2	Furnizimi dhe transporti i robatharësës me kapacitet 10 kg. Rrobatharësja duhet të jetë e cilësisë së lartë si dhe me garanci shumëvjeçare.	copë	1.00	500.00	500.00 €
9.3	Furnizimi dhe transporti i dërrasës për hekurosje me lartësi maksimale 86 cm dhe dimensione 110 x 32 cm.	copë	1.00	250.00	250.00 €
9.4	Furnizimi dhe transporti i dollapit metalik me mundësi mbylljeje për vendosjen e çantave/gjësendeve personale me dimensione 90x45xH185 cm, me 12 kompartmente/hapësirë ndarje. Dollapi duhet të jetë rezistent ndaj goditjeve dhe gërryerjes. Nuancën e përcakton organi mbikëqyrës.	copë	2.00	200.00	400.00 €
9.5	Furnizimi dhe transporti i tavolinës për stafin me 4 karrige. Tavolina me material nga druri dhe këmbë stabile ka dimensione 140x80xH75 cm. Karriget me strukturë druri dhe mbulesë të butë për ulje kanë dimensione 48x88xH59 cm.	copë	2.00	300.00	600.00 €

9.6	Furnizimi dhe transporti i karrigëve lëvizëse me rrota, me krahë dhe strukturë metalike, dhe tapiceru tekstili e rrjetëzuar e zezë. Dimenzionet e karrigës janë 47x45xH90-100 cm. Ulësja dhe mëshetësja duhet të përmbajë sfungjerë cilësor me veshje lëkure artificiale dhe tekstili.	copë	7.00	250.00	1,750.00 €
9.7	Furnizimi dhe transporti i raftit për këpucë për stafin e çerdhës. Rafti l punuar nga druri duhet të ketë dimensione 58x18xH119cm apo të ngjashme. Dollapi duhet të jetë i tipit të mbyllur me dyer.	copë	1.00	300.00	300.00 €
9.8	Furnizimi dhe transporti i tavolinës së punës për zyrën e administratës. Tavolina nga druri, përpos hapësirës për punë duhet të ketë edhe një dollap me të paktën 3 rafte. Tavolina të ketë dimensione 110x75xH55cm.	copë	1.00	1200.00	1,200.00 €
